

INSTITUTI GAP:

DERI NË VITIN 2023 NGA KOSOVA U LARGUAN MBI 350 MIJË PERSONA



Instituti GAP ka publikuar të mërkurën raportin e ri “Emigrimi dhe tregu i punës në Kosovë: potenciali i papërdorur i fuqisë punëtore joaktive”. Gjetjet e këtij raporti tregojnë se tregu i punës në Kosovë do të vazhdojë të sfidohet nga mungesa e fuqisë punëtore, kryesisht për shkak të emigrimit të qytetarëve dhe shkallës së lartë të fuqisë punëtore joaktive. Deri në vitin 2023, sipas të dhënave zyrtare, numri i personave që janë larguar nga Kosova drejt vendeve të ndryshme të botës ka arritur në 359 mijë persona, që përfaqëson rreth 22.6 % të popullsisë së vendit

TENTATIVA E NËNTË PËR KONSTITUIMIN E KUVENDIT

F. 4



AHMETI TAKON OSMANIN: SHOIPTARËT PO PËRBALLEN ME NJË OFENSIVË TË RREZIKSHME QË KA PËR QËLLIM ZHBËRJEN E SHTYLLAVE TË ARRËVESHJES PAQËSORE TË OHRIT

F. 7



AKTUALE



SPD-ja MIRATON MARRËVESHJEN PËR KOALICION, HAP RRUGËN PËR QEVERINË E RE GJERMANE

F. 2

OKSGJ: GRATË E KOMUNITETEVE, MË TË DISKRIMINUARAT NË VENDIN E PUNËS

F. 3

NGA 5 MAJI QYTETARËT E KOSOVËS MUND TË UDHËTOJNË PA VIZA NË IZRAEL, KËRKOHET VETËM AUTORIZIMI ETA-IL

F. 7

EKONOMI



GUVERNATORI ISMAILI TAKOHET ME PRESIDENTIN E BANKËS BOTËRORE, FLASIN PËR FORCIMIN E BASHKËPUNIMIT STRATEGJIK

F. 8

BANIMI I PËRBALLUESHËM DHE AI SOCIAL PO BËHEN REALITET, GURTHEMELI VIHET NË ISTOC

F. 8

SPORT



QERIMI SHPALL LISTËN PËR NDESHJET ME ISHUJT FAROE DHE HOLANDËN

F. 10

RENOVA

PUTZ

Maqedoni

Xhepcisht - Tetovë

Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009

+389 44 487 755

Fax: +389 44 487 200

Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

INFO: 049-111-101, 044-511-177

www.princesha-ks.com

FABRIKA E LLAQEVE

STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

044/256-051

044/367-061

028/532-617

MITROVICË

Kolegji BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com

info@kolegji.biznesi.com

030 500 878 | 045 500 878

044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,

Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,

E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

Endrit Shaqiri

+38344685122

Internet Website,

Marketing...

SPD-ja miraton marrëveshjen për koalicion, hap rrugën për qeverinë e re gjermane

Berlin, 30 prill - Partia Socialdemokrate (SPD) ka miratuar marrëveshjen e koalicionit qeverisës me bllokun CDU/CSU të Friedrich Merzit, duke i hapur rrugë formimit të qeverisë së re gjermane javën e ardhshme. Partia e qendrës së majtë tha më 30 prill se 84.4 për qind e anëtarëve të partisë kanë mbështetur marrëveshjen, pasi për dy javë kanë votuar online për të. SPD do të bëhet partneri i vogël në koalicionin e ardhshëm qeverisës, ku do të bëjnë pjesë Unioni krisitandemokrat (CDU) i Merzit, dhe partia simotër Unioni krisitiansocial (CSU), që veçse



kanë konfirmuar marrëveshjen për partneritet. Marrëveshja do të nënshkruhet zyrtarisht të hënën, me Merzin që pritet të zgjidhet kancelar të martën, dy muaj e gjysmë pasi blloku i tij i qendrës së djathtë fitoi zgjedhjet parlamentare të shkurtit. Sipas burimeve të Dpa-së, bashkudhëheqësi i SPD-së, Lars Klingbeil, ka mbështetje unanime të partisë së tij që të bëhet zëvendëskancelar. Së bashku, konservatorët dhe SPD-ja do të kenë një shumicë të ngushtë me 328 ulëse nga 630 ulëse në Bundestagun e ri, pavarësisht se këto parti së bashku kanë fituar më pak se 45

për qind të votave. Qeveria e re do të përballet me probleme të mëdha, pasi ekonomia e vendit është përballur me dy vjet rresht recesion dhe ka pasur një rritje ekonomike prej vetëm 0.2 për qind në çerekun e parë të këtij viti. Ndërkaq, Evropa si e tërë po varet shumë nga politika e re e Shteteve të Bashkuara, nën presidencën e Donald Trumpit. Merz është zotuar se do të bëjë ndryshime në politikën ekonomike dhe të migracionit, që kanë qenë dy çështje që kanë dominuar fushatën zgjedhore, teksa rreziku nga Rusia do të vazhdojë të mbesë një shqetësim i madh në vitet në vijim.

Si rekrutoi inteligjenca ruse të burgosur për luftën në Ukrainë

KIEV, 30 PRILL - Agjencia e inteligjencës ushtarake ruse (GRU) ka mbikëqyrur rekrutimin e të burgosurve në njësitë luftuese, të njohura si “Storm Z”. GRU-ja, po ashtu, ka financuar këto njësi dhe ka mbledhur informacione për viktimat, raporton Systema e Radios Evropa e Lirë në dokumentarin e fundit hulumtues të titulluar: “Kasaphana e Fantazmave: Si luftojnë të burgosur rusë në Ukrainë”. Projekti për të rekrutuar të burgosur për luftën në Ukrainë nisi verën e vitit 2022 – pikërisht atëherë kur organizata private mercenare, Wagner, nisi rekrutimin e të burgosurve në radhët e saj. Pjesa e menaxhimit operacional të njërive “Storm Z” u bë nga njësitë brenda Qarkut Ushtarak Jugor të Rusisë. Dy njësi ushtarake nga Garda e 8-të e Ushtrisë, së bashku me Qendrën për Trajnim dhe

Dislokim të Njësive Sulmuese dhe Përforsimeve, ishin përgjegjëse për trajnimin e luftëtarëve dhe administrimin e dokumentacionit, përfshirë edhe të dhënat financiare. Kjo qendër, e cila zhvilloi taktikat që përdoren nga njësitë sulmuese të përbëra nga të dënuarit, u krijua brenda Grupit të Bashkuar të Forcave, i cili shërben si qendër komanduese e luftës së Rusisë në Ukrainë. Fillimisht, kjo qendër u udhëhoq nga gjenerali Sergey Surovikin dhe aktualisht drejtohet nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Valery Gerasimov. Një tjetër qendër komanduese për “Storm Z” është GRU-ja. Systema ka siguruar dokumente që tregojnë se kontratat e nënshkruara nga të burgosurit kanë një klasifikim të veçantë të fshehtësisë dhe ruhen në një arkiv të posaçëm të GRU-së. Informacioni për të burgosurit e vrarë në luftë i dërgohet zyrës së inteligjencës, Drejtorisë



Kryesore të Shtabit të Përgjithshëm (GU GS, emërtimi modern për GRU-në). Ky informacion dërgohet nga Garda e 8 e Ushtrisë përmes kanaleve të sigurta të komunikimit. “Mbështetja financiare dhe përpunimi i pagesave të ndryshme për vullnetarët e kompanisë sulmuese [Z] u janë besuar njësisë ushtarake 45807, me bazë në Moskë”, thuhet në një nga dokumentet, të nënshkruar nga kolonel Sergey Ivanov i

Gardës së 8. Po ashtu, adresa e kësaj njësie është publikuar: Moskë, autostrada Horoshevskoje, 76b. Kjo është adresa e njëjtë që ka edhe selia e GRU-së, dhe komandanti i njësisë 45807 është Igor Kostyukov, i cili është udhëheqësi i GRU-së. Projekti “Storm Z” zyrtarisht u iniciua me urdhër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm më 24 shkurt 2023, sipas dokumentarit të Systema-s. Në të njëjtën kohë, Ministria e

Mbrojtjes dhe GRU-ja kanë bashkuar formacione të ndryshme mercenare në një strukturë të vetme: Korpusi i Vullnetarëve. Ky korpus përfshin njësi ku luftëtarët kanë shërbyer nën statusin e njëjtë të të ashtuquajturve vullnetarë, sikurse edhe disa njësi të BARS-it (Rezervistët sulmues të shtetit) dhe dhjetëra detashmente nga kompania private mercenare, Redut. Ish-të burgosurit nga “Storm Z” luftuan në Ukrainë nën statusin e njëjtë të vullnetarëve, pasi nënshkruan të ashtuquajturat kontrata për vullnetarë. Kontratat kishin disa kufizime. Për shembull, të burgosurit nuk mund t'i shkëpusnin vetë kontratat, ata kishin paga të ulëta dhe kishin pak përfitime. Në shkurt të vitit 2023, GRU-ja mori rolin e mbikëqyrëses ndaj pothuajse të gjitha njërive “vullnetare” dhe “Storm Z”, duket se nuk ishte përjashtim.

Rubio: ShBA-ja do të tërhiqet nëse s'ka propozime konkrete nga Ukraina dhe Rusia

UASHINGTON, 30 PRILL - Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, tha të martën se tashmë ka ardhur koha për propozime konkrete nga Rusia dhe Ukraina për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë. Ai paralajmëroi se nëse nuk ka përparim në negociatë, ShBA-ja do të tërhiqet si ndërmjetësuese, deklaroi zëdhënësja e Departamentit të Shtetit, Tammy Bruce. “Tani jemi në një moment kur dy palët duhet të paraqesin propozime konkrete për mënyrën se si të përfundojë ky konflikt”, tha

Bruce, duke cituar një deklaratë të Rubios. “Se si do të veprohet më tej është tashmë një vendim që i përket presidentit. Nëse nuk ka përparim, ne do të tërhiqemi si ndërmjetësues në këtë proces”, shtoi ajo. Kjo deklaratë vjen në të njëjtën ditë kur Kremlini refuzoi propozimin e presidentit ukrainas, Volodymyr Zelensky, për një armëpushim 30-ditor në vend të armëpushimit të propozuar nga homologu i tij rus, Vladimir Putin, për tri ditët kur shënohet Dita e Fitores në Rusi,



nga 8 deri më 10 maj. Përpjekjet për të arritur një armëpushim dypalësh ose një marrëveshje më të gjerë paqeje u përsheptuan pasi presidenti amerikan Donald Trump mori detyrën në janar, duke premtuar se do ta përfundonte luftën brenda 24 orëve. Paraardhësi i tij, Joe Biden, refuzoi të angazhohej në bisedime të thella me Moskën për aq kohë sa pushtimi vazhdon. Megjithatë Trumpi ka hapur bisedime të drejtpërdrejta me

Moskën, zyrtarët rusë kanë kërkuar t'i zgjerojnë negociatat për të përfshirë jo vetëm konfliktin në Ukrainë, por edhe marrëdhëniet më të gjera dypalëshe midis Uashingtonit dhe Moskës. Rusia dhe Ukraina ranë dakord për një armëpushim të kufizuar në mars, por të dyja palët kanë vazhduar ta sulmojnë njëra-tjetrën. Në fushëbetejë, forcat ruse kanë shfrytëzuar përparësinë, si në numër njerëzish ashtu edhe në armatim, për t'i lodhur trupat e Ukrainës.

INSTITUTI GAP: DERI NË VITIN 2023 NGA KOSOVA U LARGUAN MBI 350 MIJË PERSONA

Instituti GAP ka publikuar të mërkurën raportin e ri “Emigrimi dhe tregu i punës në Kosovë: potenciali i papërdorur i fuqisë punëtore joaktive”. Gjetjet e këtij raporti tregojnë se tregu i punës në Kosovë do të vazhdojë të sfidohet nga mungesa e fuqisë punëtore, kryesisht për shkak të emigrimit të qytetarëve dhe shkallës së lartë të fuqisë punëtore joaktive. Deri në vitin 2023, sipas të dhënave zyrtare, numri i personave që janë larguar nga Kosova drejt vendeve të ndryshme të botës ka arritur në 359 mijë persona, që përfaqëson rreth 22.6 % të popullsisë së vendit

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 30 PRILL - Instituti GAP ka publikuar raportin e ri “Emigrimi dhe tregu i punës në Kosovë: potenciali i papërdorur i fuqisë punëtore joaktive”. Gjetjet e raportit u paraqitën në kuadër të diskutimit të Forumit të Platformës për Dialog Publiko-Privat të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime (KKEI) mbi zhvillimin e fuqisë punëtore. Gjetjet e këtij raporti tregojnë se tregu i punës në Kosovë do të vazhdojë të sfidohet nga mungesa e fuqisë punëtore, kryesisht për shkak të emigrimit të qytetarëve dhe shkallës së lartë të fuqisë punëtore joaktive. Deri në vitin 2023, sipas të dhënave zyrtare, numri i personave që janë larguar nga Kosova drejt vendeve të ndryshme të botës ka arritur në 359 mijë persona, që

përfaqëson rreth 22.6 % të popullsisë së vendit, ndërkaq numri i shtetasve kosovarë të kthyer si dhe të huajt që jetojnë në Kosovë është rreth 99 mijë persona. Një pjesë e personave të cilët po emigrojnë nga Kosova janë nga fuqia punëtore aktive, çka po ndikon në rritjen e kërkesës në vend për punëtorë vendas dhe të huaj. Në vitin 2024 Ministria e Punëve të Brendshme (MBP) në Kosovë lëshoi gjithsej 8 293 leje-qëndrime për shtetas të huaj, prej tyre 3 974 për arsye të punësimit. Shumica e këtyre imigrantëve janë me origjinë nga shtetet e rajonit si Shqipëria, Serbia, Maqedonia e Veriut dhe vendet jashtë rajonit si Turqia, Bangladeshi, Filipinet dhe shtetet tjera të Azisë. Megjithatë, mbi gjysma e këtyre lejeve të lëshuara janë vazhdimësi e viteve paraprake. Si rrjedhojë, bilanci i emigrimit mbetet shumë më i lartë se i imigrimit dhe punëtorët e huaj nuk e mbulojnë mungesën e krijuar në tregun e punës.



Zgjidhja më e qëndrueshme për ta adresuar mungesën e fuqisë punëtore në Kosovë është rritja e përfshirjes në treg e personave që i takojnë moshës së punës, por që aktualisht nuk janë aktivë në treg (të cilët nuk janë duke punuar dhe nuk janë duke kërkuar punë). Kosova ka shkallën më të lartë të joaktivitetit në Ballkanin Perëndimor: nga rreth 1.1 milion persona në moshë pune, vetëm 461 mijë persona (43 %) janë ekonomikisht aktivë, ndërsa 613 mijë persona (57 %) janë joaktivë. Nga personat joaktivë, 66 % janë gra dhe 34 % janë burra, që nënkupton se veçmas pjesëmarrja e ulët e grave në tregun e punës mbetet sfidë serioze. Kosova radhitet e para në Evropë dhe e pesta në nivel

botëror për pjesëmarrjen më të ulët të grave në treg të punës. Po ashtu, 78 mijë të rinj (30 %) nuk janë të angazhuar në arsim, punë apo trajnim (NEET), një përqindje shumë më e lartë se mesatarja e BE-së (9.9 %) dhe më e larta në rajon. Sektorët më të prekur nga mungesa e fuqisë punëtore janë ndërtimtaria, tregtia me shumicë dhe pakicë, gastronomia dhe hoteleria, dhe prodhimi, nga të cilët edhe prirja për të emigruar është më e lartë. Shumica e pozitave të punës në këta sektorë nuk kërkojnë kualifikime të larta, por përfshijnë detyra të cilat mund të mësohen brenda një periudhe të shkurtër duke sugjeruar se fuqia joaktive vendore do të mund të plotësonte këto kërkesa. Raporti ofron disa

rekomandime dhe masa të cilat synojnë ta përmirësojnë përfshirjen e fuqisë punëtore joaktive në tregun e punës, si: trajnime për avancimin e njohurive dhe përfshirjen më të lehtë në tregun e punës; mbështetje për rritjen e pjesëmarrjes së grave dhe të rinjve në tregun e punës; forcimin e rolit të Agjencisë së Punësimit; si dhe mbështetje për teknologjitë inovative dhe avancimi i shkathtësive në fushën e energjisë së pastër. Në diskutim ishin të pranishëm edhe aktorë të institucioneve publike dhe private, duke përfshirë edhe shoqatat e bizneseve, dhe që rekomandimet e Institutit GAP do të evidentohen dhe paraqiten në diskutimet e mëtejme në kuadër të dialogut publiko-privat.

QKSGJ: Gratë e komuniteteve, më të diskriminuara në vendin e punës

PRISHTINË, 30 PRILL - Gratë e komunitetit rom, ashkali, egjiptian dhe nga komuniteti LGBTQI janë ato që po diskriminohen më së shumti në vendet e tyre të punës, duke u përballur me sfida sa i përket punësimit të qëndrueshëm, u tha të mërkurën në publikimin e dokumentit “Diskriminimi gjinor në tregun e punës në Kosovë” nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore. Autorja e raportit, Lavdi Zymberi, tha se në këto komunitete është hasur edhe ngacmimi seksual në vendin e punës, dhe që nuk është raportuar, sipas saj, për shkak të frikës nga largimi i punës, raporton KP. “Sipas gjetjeve



tona, edhe nga raporti edhe grupi i fokusuar, ato tregojnë se shumë gra, sidomos gratë që vijnë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian ose

nga komuniteti LGBTQI, por edhe ato që kanë aftësi të kufizuara, përballen me shumë sfida sa i përket punësimit, sidomos atij të

qëndrueshëm, por edhe trajtim të barabartë në vend të punës. Komunitetet ngacmimin seksual e kanë përmendur shumë që ekziston në vendin e punës, megjithatë nuk raportohet aq sa duhet shkak i frikës nga ndëshkimi”, tha Zymberi. Ndërsa drejtoresha ekzekutive e QKSGJ, Luljeta Demolli, shtoi se institucionet e vendit me vite të tëra nuk kanë përkushtim maksimal për ta luftuar diskriminimin gjinor në punë dhe për krijimin e Ligjit të Ri të Punës. “Ka vite që institucionet tona nuk kanë një përkushtim maksimal dhe nuk e kanë marrë asnjëherë përsipër që ta krijojnë një ligj të ri të punës

dhe t'i adresojnë çështjet në mënyrë më urgjente. Qytetarët e Kosovës tashmë njohin shtetet e Evropës, e dinë sa mirë është kur je punëtor, në kuptimin që të drejtat janë të mbrojtura dhe do të donim që një frymë e tillë të jetë edhe në Kosovë, në ligjet tona”, shtoi Demolli. Ky dokument i pozicionimit është realizuar me mbështetjen e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë përmes projektit “Avancimi i barazisë gjinore dhe diversitetit përmes eliminimit të diskriminimit me bazë gjinore në vendin e punës”, i zbatuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore dhe Iniciativa Kosovare për Stabilitet.



TENTATIVA E NËNTË PËR KONSTITUIMIN E KUVENDIT

Sot (e enjte) deputetët e Kuvendit të Kosovës do të mbledhen sërish për ta konstituuar përbërjen e Kuvendit të Kosovës të dalë nga zgjedhjet e 9 shkurtit. E propozuara për kryeparlamentare nga Lëvizja Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, në disa seanca radhazi nuk i ka marrë votat e nevojshme për këtë pozitë. Ajo të martën mori 54 vota për, tri vota më pak se herëve të tjera. Mbetet të shihet në këtë seancë vazhduese nëse LV-ja do të dalë me emër tjetër për kryeparlamentar apo do të vazhdojë sërish me Haxhiun

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 30 PRILL - Tetë herë u mbledhën, po kaq herë dështuan ta çojnë në fund konstituimin e Kuvendit të Kosovës. Deputetët e rinj nuk po arrijnë të gjejnë mirëkuptim për votimin e kryetarit të ri të Kuvendit. E propozuara për kryeparlamentare nga Lëvizja Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, nuk po i merr votat e nevojshme. Ajo të martën mori 54 vota për, 44 kundër dhe 3 abstenuan. Në seancat paraprake për të kishin votuar 57 deputetë, por në seancën e fundit tri vota munguan. Ndërkaq sërish sot (e enjte) në orën 10:00 do të mbledhet vazhdimi i seancës për ta konstituuar përbërjen e Kuvendit të Kosovës të dalë nga zgjedhjet e 9 shkurtit. Mbetet të shihet në këtë seancë vazhduese nëse LV-ja do të dalë me emër tjetër për kryeparlamentar apo do të vazhdojë sërish me Haxhiun. Seanca konstituive ka nisur më

15 prill dhe në shtatë seancat paraprake deputetët kanë arritur të kalojnë vetëm dy pikat e para të rendit të ditës - miratimin e raportit të Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe Betimin e Deputetëve, por kanë ngecur në pikën e tretë, atë të zgjedhjes së kreut të ri të organit legjislativ. Të martën deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Hekuran Murati, tha se si kompromis kanë ofruar që partia e tij, së bashku me Partinë Demokratike të Kosovës dhe Lidhjen Demokratike të Kosovës, të pajtohen që të votohen në paketën kryeparlamentare dhe tri nënkryetarët. "Ajo që kemi ofruar si kompromis është një dakordim politik, një konsensus politik që të tri partitë më të mëdha, që u takon të propozojnë kandidatë për nënkryetarë, përveç përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë në Kuvend, të mbledhen, të dakordohen [të votohen] në paketë emri i kandidatës

kryeparlamentare Albulena Haxhiu si dhe emrat e nënkryetarëve, në mënyrë që të vazhdohet tutje dhe të kemi dakordim që t'i votojmë", tha ai. Murati hodhi poshtë akuzat e partive se LV-ja po kërkon që Haxhiu "të votohet me zor", duke shtuar se disa deputetë të partive, që legjislacionin e kaluar ishin në opozitë, kanë shprehur "dëshirë që të dalin nga kjo situatë", por shtoi se partitë e tyre nuk kanë ndryshuar qëndrim, andaj ata nuk po mund të votojnë për Haxhiun. LV-ja, përsëriti ai, nuk është e interesuar për mbajtjen e zgjedhjeve të reja, por është e gatshme për votime të reja, nëse ky mbetet opsioni i vetëm për daljen nga situata e krijuar. Ndërkaq kreu i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, tha se LV-ja ka "mentalitet të imponimit", pasi kjo parti ka të drejtë ta propozojë kryeparlamentarin, por jo të imponojë se si votojnë të zgjedhurit e popullit. Ai e

akuzoi LV-në se "me qëllim po mban të bllokuar" procesin e krijimit të institucioneve të reja, teksa shtoi se kishte tri mesazhe për partinë fituese të zgjedhjeve. "E para, demokracia funksionon me shumicë e jo me imponim. E dyta, institucionet janë të popullit, nuk janë të asnjë partie politike të veçantë. Dhe, e treta, duhet ta kuptojnë të gjithë se koha e sundimit njëpartiak dhe e monizmit ka përfunduar. Sa më parë që t'i kuptojë LV-ja këto tri çështje, aq më mirë për vendin", tha Krasniqi. Shefja e grupit parlamentar e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Hykmete Bajrami, tha se insistimi i LV-së për ta propozuar Haxhiun për pozitën e kryeparlamentares e ka shndërruar Kuvendin "në një cirk". "LDK-ja është për gjetjen e një zgjidhjeje kushtetuese që respekton Kushtetutën dhe rezultatin e zgjedhjeve. Ne e njohim të drejtën e të parit për të propozuar, por kjo nuk do të thotë se ne e bartim votën te një subjekt duke votuar sipas kërkesave të tyre", tha ajo, duke shtuar se përgjegjësia për këtë situatë bie mbi partinë e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti. Ndërkaq para nisjes së seancës, kreu i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, tha se LV-ja nuk do ta marrë votën e partisë

nëse insiston në kandidimin e Haxhiut. "Nëse ndryshohet kandidati [për kryeparlamentar], sot do të votohet. Por, si duket, do të jemi në situatë të njëjtë", tha ai për gazetarët para nisjes së seancës. Ndërsa kreu i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, tha se i takon LV-së të bëjë përpjekje maksimale për të formuar një shumicë parlamentare. "Shumica parlamentare nënkupton koalicion qeverisës edhe për Kuvend edhe për qeveri, kështu ka ndodhur edhe herën e kaluar", tha ai. Nisma, sipas Limajt, do të kontribuojë që të evitohen zgjedhjet e reja, "por jo me çdo kusht". "Nëse nuk ka zgjidhje, ka zgjidhje tjetër. Ato janë zgjedhjet", tha ai para nisjes së seancës. Naim Rashiti, drejtor i Grupit Ballkanik për Politika në Prishtinë, ka thënë se zgjedhjet duhet të jenë zgjidhja e fundit. Ai në "Facebook" ka dhënë dhjetë opsione për dalje nga kriza politike. Opsionet e tij: "1. LV duhet të propozojë tre kandidatë për kryetar/e të kuvendit. Deputetët (së paku pjesa më e madhe e tyre) do të votojnë njërin prej tyre. 2. Një grup i deputetëve duhet me urgjencë të dërgojnë një pyetje specifike në Gjykatën Kushtetuese. 3. LV-ja të bëjë marrëveshje politike me subjekte parlamentare. As bashkëpunimi me Nismën

KDI: FERIZAJ, GJAKOVA, LIPJANI DHE PRIZRENI, KOMUNAT MË TRANSPARENTE MË 2024

PRISHTINË, 30 PRILL - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në bashkëpunim me Transparency International Kosova, ka publikuar të mërkurën raportin vjetor “Transparometri Komunal 2024”, i cili vlerëson nivelin e transparencës në 38 komunat e Kosovës për periudhën janar - dhjetor 2024. Në hapje të konferencës, menaxherja e projekteve në KDI, Selvi Kurti, theksoi rëndësinë e transparencës dhe llogaridhënies në nivelin lokal të qeverisjes. Ajo deklaroi se transparenca nuk është çështje vullneti, por detyrim ligjor dhe instrument kyç për ndërtimin e besimit midis qytetarëve dhe institucioneve. Gjatë vitit 2024 një zhvillim i rëndësishëm ishte parajmërimi për lansimin e platformave të reja digjitale komunale, me synimin për të përfunduar këtë proces deri në fund të dhjetorit. Megjithatë, procesi është shoqëruar me mangësi të theksuara, si mungesa e njoftimeve zyrtare,



afateve të qarta dhe udhëzimeve për qytetarët lidhur me përdorimin e uebfaqeve të reja. Besnik Ramadanaj nga KDI-ja paraqiti metodologjinë e raportit dhe rezultatet kryesore.

Sipas tij, vlerësimi mesatar për 38 komunat ishte 68.34 pikë, një ngritje prej rreth 5 për qind krahasuar me vitin 2023. Komunat me performancën më të mirë në transparencë për vitin 2024 janë: Ferizaj, Gjakova,

Lipjani dhe Prizreni, pasuar nga Drenasi, Klina, Obiliqi dhe Rahoveci. Raporti, gjithashtu, analizoi performancën në nivel të kuvendeve komunale dhe zyrave të kryetarëve.

Zyrat e kryetarëve shënuan rritje të lehtë me 71.56 për qind, ndërsa kuvendet komunale me 71.03 për qind, duke treguar përmirësim krahasuar me vitin 2023. Me gjithë përmirësimet, raporti identifikoi disa sfida të vazhdueshme, përfshirë mungesën e njoftimeve publike për qytetarët lidhur me lansimin e uebfaqeve të reja, mungesën e informatave publike për adresat e komunave, mungesën e strukturës unike dhe të standardizuar të uebfaqeve dhe mungesën e qasjes së plotë në dokumente në gjuhët zyrtare. Duke qenë se viti 2025 është një vit zgjedhor komunal, KDI-ja inkurajon komunat ta forcojnë transparencën dhe të mos e neglizhojnë atë gjatë kësaj periudhe. Gjithashtu, kandidatët për kryetarë komunash inkurajohen të hartojnë dhe publikojnë programe që i japin rëndësi transparencës dhe llogaridhënies.

ORAV: KËTË VIT DO TË NDAHEN 7.7 MILIONË EURO PËR 12 KOMUNA ME PERFORMANCË TË LARTË

PRISHTINË, 30 PRILL - Ambasadori i BE-së në Kosovë, Aivo Orav, në konferencën dhe panelet e diskutimit për Grantin e Performancës Komunale, ka theksuar rëndësinë e kësaj ngjarjeje si një çast për t'i vlerësuar arritjet e komunave dhe për ta forcuar qeverisjen lokale. Ai u shpreh se granti nuk është vetëm një mbështetje financiare, por një mjet i fuqishëm për ta nxitur përmirësimin institucional dhe ofrimin më të mirë të shërbimeve për qytetarët. “Kjo është një ngjarje e rëndësishme, ku njohim arritjet e jashtëzakonshme të komunave të Kosovës dhe festojmë përkushtimin tonë të përbashkët për forcimin e qeverisjes lokale. Jemi të kënaqur që mbështesim këtë nismë të vlefshme, e cila është zhvilluar në partneritet të ngushtë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Granti për Performancë Komunale nuk shërben vetëm si një instrument financiar por, mbi të gjitha, si një shtytës kyç për komunat. Përmes këtij granti, komunat inkurajohen ta



përmirësojnë performancën institucionale dhe të ofrojnë shërbime publike me më shumë efikasitet dhe me përgjegjshmëri më të madhe ndaj nevojave të qytetarëve”, ka pohuar ambasadori Orav. Ai ka theksuar se këtë vit do të ndahen 7.7 milionë euro për 12 komuna që kanë treguar performancë të lartë. “Këtë vit, një shumë prej gjithsej 7.7 milionë eurosh do t'u ndahet 12 komunave të dalluara, të cilat kanë investuar shumë energji dhe përpjekje. Ju shprehim urimet tona më të përzemërta secilit prej jush. Gjatë konferencës së sotme, Timur do të flasë për rëndësinë e sistemit të menaxhimit të performancës në përmirësimin e qeverisjes lokale. E shfrytëzoj këtë rast për të përsëritur se arsyeja pse Bashkimi Evropian ka investuar në këtë nismë novatore është sepse Granti për Performancë Komunale ka dëshmuar se ndihmon në përmirësimin e qeverisjes së mirë në nivel lokal. Qëllimi i saj shkon përtej rritjes së investimeve kapitale në nivel komunal”, ka thënë Orav.

nuk arrihet pa marrëveshje politike për bashkëqeverisje. 4. Në rast të dështimit të LV-së për të siguruar votat për formimin e qeverisë, opozita do të ketë shansin e vet, por nuk e ka të garantuar. 5. Koha për leadership të guximshëm e marrëveshje të mëdha politike

të guximshme për bashkëqeverisje. Marrëveshjet politike duhen tani apo pas përsëritjes së zgjedhjeve të reja. 6. Një opsion është që partia fituese LV-së të formojë një qeveri minore, me mbështetjen e disa subjekteve apo deputetëve, me kusht që

ata marrin kryetarin e kuvendit. Kjo qeveri duhet të jetë me mandat shumë të kufizuar kohor. 7. Qeveri teknike. Nëse LV-ja, PDK-ja dhe LDK-ja besojnë se blloqet e tyre nuk mund të formojnë qeverinë, ato duhet të pajtohen për një qeveri

teknike (përfshirë programin dhe prioritetet) me mandat deri në shkurt të vitit 2026. 8. Nëse të gjitha këto opsione nuk funksionojnë, subjektet politike duhet të pajtohen për shpalljen e zgjedhjeve të reja sa më shpejt. 9. Dhe për të gjitha opsionet duhet dialog të

nivelit të lartë politik në mes të liderëve. 10. Mungesa e dialogut do të thellojë krizën dhe detyrojë subjektet të bëjnë zgjidhje të rrezikshme për të ardhmen dhe funksionimin e institucioneve”, ka thënë Rashiti.

REAGIM NGA KËSHILLI PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE TË LIRIVE TË NJERIUT (KMDLNJ)

DISKRIMINIM KUNDËRKUSHTETUES NË BAZA ETNIKE, KU ËSHTË PROKURORIA?!

ZRrE, kohë më parë, me pajtimin e Qeverisë së Kosovës, rriti përsëri çmimin e energjisë elektrike për 16.1 për qind që pastaj në mënyrë zinxhirore u rritën çmimet e të gjithë artikujve dhe shërbimeve. Ishin disa protesta të qytetarëve, por që nuk i bënë përshtypje as ZRrE-ja e as Qeverisë së Kosovës. ZRrE një kohë të gjatë ka plaçkitur mjetet e qytetarëve shqiptarë dhe joserbë duke i fryrë faturat për t'i paguar faturat e rrymës për serbët që nuk kanë paguar rrymën, ujin, mbeturinave e as tatimin në pronë që nga përfundimi i luftës. Sot rrymën e paguajnë simbolikisht, nuk ka informata të sakta nga asnjë institucion i pavarur dhe i besueshëm. Sistemi energjetik i Kosovës në

veri të vendit udhëhiqet nga “Elektroseveri” që nënkupton se ata nuk i përgjigjen autoriteteve të Kosovës. Në këtë kontekst, “Elektroseveri” nuk ka pranuar të rrisë çmimet e rrymës në veri të Kosovës sikur që nuk i çkyqë nga rrjeti i furnizimit serbët ndonëse ata nuk i paguajnë faturat. Konsumatorët e plaçkitur nga ZRrE-ja, ndonëse është vendimi i gjykatës nuk po kompensohen për mjetet e vjedhura duke thënë se KEDS-i po e pamundëson këtë. Me Kushtetutën e Kosovës është përcaktuar qartë rastet kur minoritetet përfitojnë por se Kushtetuta e Kosovës shprehimisht kundërshton diskriminimin e qytetarëve në baza etnike, fetare, gjinore, racore, të moshës, statutit shoqëror etj. Trajtimi i qytetarëve



në baza etnike në rastin e faturave të rrymës është diskriminim flagrant, shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut si dhe veprim puro racist nga ZRrE, “Kosovaseveri” dhe Qeveria e

Kosovës. Prokuroria Speciale duhet me urgjencë ta trajtojë këtë diskriminim, sipas detyrës së sikur që duhet të propozojë gjykatës që të pezullojë vendimin e ZRrE-së. Gjithashtu duhet t'i

merret leja e punës “Elektroseverit” shkak se vepron në kundërshtim me ligjet e Kosovës duke diskriminuar qytetarët dhe konsumatorët ekskluzivisht në baza etnike. Qytetarët duhet të kundërshtojnë këtë trajtim diskriminues duke protestuar kundër ZRrE-së, “Eektroseverit” dhe Qeverisë së Kosovës. Po të ishte Kosova anëtare e Këshillit të Evropës, këtë diskriminim të motivuar krejtësisht në baza etnike do ta paguante shtrenjtë materialisht dhe politikisht. Prandaj edhe nuk ka asnjë interes që të anëtarësohet në Këshill të Evropës. Asnjë qeveri deri më tani nuk i ka shkelur aq brutalisht të drejtat politike, ekonomike dhe sociale të qytetarëve të Kosovës.

PAS RRYMËS, SHTRENJTOHEN BUKA DHE KAFEJA? AUTORITETI I KONKURRENCËS DEKLAROHET PËR SITUATËN

Prishtinë, 30 prill - Qytetarët në Kosovë po përballen me rritje të vazhdueshme të çmimeve, që nga produktet bazë deri te shërbimet e ndryshme. Së fundmi, pas shtrenjtimit të energjisë elektrike për 16.1 për qind, është paralajmëruar edhe rritje e çmimeve për bukën dhe kafën.

Përballë kësaj situatë qytetarët po shprehin shqetësimin e tyre, duke thënë se nuk mund ta përballojnë më shtrenjtimin e njëpasnjëshme. Ata kërkojnë nga institucionet të ndërmarrin masa për t'i mbrojtur konsumatorët. Për situatën e krijuar, “Telegrafi” - i ka kontaktuar me Autoritetin e Konkurrencës së Kosovës. Nga ky institucion kanë deklaruar se ata mund të ndërhyjnë vetëm në rastet kur dyshohet se çmimet



janë përcaktuar përmes marrëveshjeve të fshehta mes operatorëve ekonomikë. “Fillimisht, dëshirojmë të sqarojmë se Autoriteti i Konkurrencës së Kosovës nuk ka kompetenca për të përcaktuar apo ulur çmime, pasi në një ekonomi të tregut të lirë, çmimet

përcaktohen individualisht nga ndërmarrjet, në bazë të kushteve të tregut dhe kostove të tyre. Megjithatë, Autoriteti ndërhyr në rastet kur dyshohet se çmimet janë përcaktuar përmes marrëveshjeve të fshehta apo bashkërendimeve të ndaluara ndërmjet ndërmarrjeve

konkurrente, në kundërshtim me Ligjin nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, konkretisht nenin 5 të tij”, thuhet në përgjigjen e Autoritetit të Konkurrencës. Më tej, sqaron se është duke monitoruar vazhdimisht zhvillimet në treg. “Lidhur me situatën në treg, autoriteti është duke monitoruar në vazhdimësi zhvillimet në treg, përfshirë sektorin e produkteve ushqimore dhe të gastronomisë. Aktualisht jemi në fazën e analizës së rreth 20 produkteve bazike”, vijon më tej përgjigjja. Ndërsa sa iu përket çmimeve në sektorin e gastronomisë, thekson se inspektorët janë vazhdimisht në terren. “Për sa i përket sektorit të gastronomisë, sidomos rritjes së çmimit të kafesë, inspektorët tanë vazhdimisht janë duke

zhvilluar vizita në terren në qytete të ndryshme të Kosovës, duke komunikuar me pronarë të kafiterive dhe përfaqësues të sektorit për të identifikuar: arsyet e ngritjes së çmimit; dhe nëse ka ndodhur ndonjë koordinim apo dakordim i ndaluar për rritje të njëanshme të çmimeve. Pasi të përfundojë faza e analizës së tregut dhe mbledhjes së informatave dhe nëse identifikohen indicie për shkelje të ligjit, Autoriteti do të ndërmarrë të gjitha veprimet e parapara me legjislacionin në fuqi”, ka pohuar Autoriteti i Konkurrencës. Së fundmi, në rrjetet sociale kanë qarkulluar disa fotografi, ku thuhet se çmimi i një makiazoje është bërë dy euro, ndërsa buka në disa furra kushton 60 centë e në disa të tjera 70 centë.

Nga 5 maji qytetarët e Kosovës mund të udhëtojnë pa viza në Izrael, kërkohet vetëm autorizimi ETA-IL

Prishtinë, 30 prill - Duke filluar nga data 5 maj 2025, qytetarët e Kosovës do të mund të udhëtojnë pa viza në shtetin e Izraelit për qëllime turistike. Këtë e ka bërë me dije ambasadorja e Shtetit të Izraelit në Republikën e Kosovës, Tamar Ziv, përmes një postimi në platformën “X”. “Duke filluar nga data 5 maj 2025, vizitorët nga Kosova që mbajnë një pasaportë kombëtare të vlefshme të Kosovës dhe që planifikojnë ta vizitojnë Shtetin e Izraelit për

qëllime turistike, do të përfshihen në listën izraelite të vendeve të përjashtuara nga viza”, ka shkruar ambasadorja. Megjithatë, udhëtarët duhet të pajisen me një ETA-IL (Autorizim Elektronik për Udhëtim) para se të nisen drejt Izraelit. “Të gjithë shtetasit e Kosovës që planifikojnë ta vizitojnë Izraelin duhet të aplikojnë për ETA-IL të paktën 72 orë para mbërritjes”, sqaron Ambasada. ETA-IL është një miratim elektronik që lejon hyrjen dhe

qëndrimin në Izrael deri në 90 ditë për çdo vizitë. “Të gjithë udhëtarët drejt Izraelit duhet të kenë një vizë të vlefshme ose një miratim ETA-IL përpara se ta nisin udhëtimin e tyre. Marrja e një ETA-IL është një proces i thjeshtë dhe i shpejtë, nëse i plotëson kushtet”, thuhet më tej në njoftim. Ambasada e Izraelit në Kosovë u drejtohet qytetarëve me një ftesë miqësore: “Mirë se vini në Izrael dhe ju urojmë një vizitë të mrekullueshme!”.



Bajrami: Drejtësia të veprojë ndaj uzurpatorëve të posteve qeveritare

PRISHTINË, 30 PRILL - Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, ka kërkuar nga institucionet e drejtësisë që të veprojnë sa më parë ndaj bllokuesve të punëve publike dhe uzurpatorëve të posteve qeveritare lidhur me situatën e krijuar në mes të komunës së Prishtinës dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), për hapjen e sheshit “Xhorxh Bush”. “Institucionet e Republikës së Kosovës siç janë Policia e Kosovës, inspektoratet e të tjera nuk duhet të lejojnë të instrumentalizohen e

keqpërdoren nga deputetët e LV-së, të cilët tashmë kanë shkelur betimin e deputetit, ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Xhelal Sveçla, Hajrullah Çeku dhe ish-ministra të tjerë, tashmë deputetë nuk kanë asnjë autorizim apo autoritet më shumë se deputetët e tjerë të Kuvendit të Kosovës. Prandaj askush s’duhet t’u nënshtrohet dhe t’i përfillë urdhrat dhe kërkesat e tyre, joligjore dhe për interesa të ulëta politike”, ka shkruar Bajrami. Ajo ka shtuar se LV-ja tash e katër vjet përmes pushtetit nuk ka lënë komunë pa e bllokuar -


herë duke ndalur fondet, herë projektet. “Por ngjarjet e ditëve të fundit, me rastin e sheshit ‘Xhorxh Bush’, nuk janë vetëm kundër komunës së Prishtinës, por edhe kundër vetë qytetarëve - një skandal më vete. Bllokuesve dhe uzurpatorëve, të cilët paradite dërgojnë letër se gjithçka është në rregull dhe pasdite përdorin policinë për t’i ndërprerë punimet, duhet t’u thuhet: mjaft! Institucionet e drejtësisë duhet të veprojnë sa më parë kundër bllokuesve të punëve publike e uzurpatorëve të posteve qeveritare!”, ka shkruar deputetja Bajrami.



AHMETI TAKON OSMANIN: SHQIPTARËT PO PËRBALLEN ME NJË OFENSIVË TË RREZIKSHME QË KA PËR QËLLIM ZHBËRJEN E SHTYLLAVE TË MARRËVESHJES PAQËSORE TË OHRIT

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 30 PRILL - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim kryetarin e Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, i shoqëruar nga ish-ministri i Jashtëm, Bujar Osmani dhe sekretarja për barazi gjinore, Arta Bilalli-Zendeli. Gjatë takimit u diskutua për zhvillimet aktuale politike në Kosovë dhe në rajon, me theks të veçantë në rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe përfaqësuesve politikë shqiptarë në Maqedoninë e Veriut. Presidentja Osmani theksoi se shqiptarët në Maqedoninë e Veriut janë faktorë thelbësor për stabilitetin dhe integrimin e këtij shteti. Siç ka deklaruar edhe më parë, presidentja Osmani ritheksoi se shqiptarët janë popull konstituiv në Maqedoninë e Veriut dhe forcë vendimtare që kanë drejtuar vendin drejt integritetit euroatlantik. Prandaj, çdo tendencë për shkeljen e Marrëveshjes së Ohrit sa iu përket të drejtave tashmë të fituara e të konfirmuara të shqiptarëve në RMV duhet të kundërshtohet me vendosmëri nga të gjithë shqiptarët në RMV si dhe i gjithë faktori shqiptar në rajon. Në këtë kuadër ajo rikonfirmoi përkushtimin e Republikës së Kosovës për ta thelluar



bashkëpunimin me të gjitha forcat që punojnë në shërbim të paqes, stabilitetit dhe perspektivës euroatlantike të të gjithë rajonit. Ahmeti falënderoi presidenten Osmani për mikpritjen dhe e vlerësoi lart rolin e saj udhëheqës në përfaqësimin me dinjitet të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Ai uroi për

mbarëvajtjen e zgjedhjeve dhe uroi formim sa më të shpejtë të institucioneve si dhe u pajtua për nevojën për bashkëkomunikim dhe bashkëpunim më të ngushtë të qëndrimeve në mbrojtje të interesave të përbashkëta dhe për ruajtjen e stabilitetit, paqes dhe integritetit euroatlantik në rajon. Në këtë kontekst, Ahmeti ngriti

shqetësimin e thellë për përkeqësimin e situatës politike dhe institucionale në Maqedoninë e Veriut, ku shqiptarët janë vënë në shënjestër nga një bosht hibrid politik-oligarkik me bazë supremaciste etnike dhe me një përfaqësim të inxhinieruar politik të shqiptarëve. “Sot shqiptarët po përballen me një

ofensivë të rrezikshme që ka për qëllim zhbërjen e shtyllave të Marrëveshjes Paqësore të Ohrit. Gjykata Kushtetuese është shndërruar në një instrument partiak që po anulon themelet e barazisë si gjuha shqipe dhe mekanizmat e balancuesit dhe badenterit. Kjo është një shkelje flagrante e barazisë ndëretnike”, ka thënë Ahmeti.

Dëmtohet vetura e u. d. drejtorit të QKUK-së, dyshohet për shpërthim

Prishtinë, 30 prill - Vetura private e ushtruesit të detyrës së drejtorit të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), Osman Hajdari, është dëmtuar nga një shpërthim i dyshuar paraditen e 30 prillit. Nga Policia e Kosovës thanë për “Radion Evropa e Lirë” se

në orën 10:00 pranuan informacionet lidhur me dyshimet për një shpërthim në një veturë, që ishte në parkingun e QKUK-së. “Aktualisht nuk raportohet për të lënduar, përveç dëmeve materiale”, thanë nga Policia. Ndërkaq Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës

(ShSKUK) tha se “dëmtimi ka ndodhur në rrethana ende të panjohura”. ShSKUK-ja tha se dëmtimi i veturës private ndodhi në kohën kur po bëheshin përgatitjet e mbledhjes së rregullt të Bordit Drejtues të këtij institucioni, “e cila ishte paraparë të mbahej në

hapësirat e administratës qendrore të ShSKUK-së”. “ShSKUK shpreh shqetësim dhe keqardhje lidhur me rastin, duke ofruar bashkëpunimin e plotë me autoritetet përkatëse”, u tha në njoftim. Nga Policia e Kosovës thanë se kanë dalë në vendin e ngjarjes



dhe se po trajtojnë rrethanat e këtij incidenti.

GUVERNATORI ISMAILI TAKOHET ME PRESIDENTIN E BANKËS BOTËRORE, FLASIN PËR FORCIMIN E BASHKËPUNIMIT STRATEGJIK

PRISHTINË, 30 PRILL - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, ka takuar presidentin e Grupit të Bankës Botërore, Ajay Banga, në kuadër të takimeve pranverore 2025 të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore. Gjatë diskutimit guvernatori Ismaili dhe presidenti Banga vlerësuan lart partneritetin e shkëlqyeshëm dhe të qëndrueshëm ndërmjet Kosovës dhe Bankës Botërore, duke u përqendruar në përparimin e projekteve në vijim që synojnë rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike, zhvillimin e sektorit financiar dhe forcimin e kapaciteteve institucionale. Guvernatori Ismaili mirëpriti vazhdimin e bashkëpunimit

me Bankën Botërore, duke theksuar rëndësinë e asistencës teknike dhe mbështetjes strategjike në funksion të avancimit të kapaciteteve institucionale të BQK-së. Ai shprehu mirënjohje të thellë për rolin e Bankës Botërore në avancimin e reformave kyçe dhe iniciativave për ndërtimin e kapaciteteve që janë në përputhje me objektivat afatgjata të institucionit. Një moment i rëndësishëm ishte edhe arritja e statusit të ri të Kosovës si kontribuuese në Shoqatën për Zhvillim Ndërkombëtar (IDA) - një arritje e rëndësishme që pasqyron rolin gjithnjë më aktiv të Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe përkushtimin e saj ndaj zhvillimit global. Guvernatori Ismaili shprehu



falënderime për mbështetjen e vazhdueshme të Bankës Botërore ndaj Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe rikonfirmoi përkushtimin e institucionit për të thelluar më tej bashkëpunimin në vitet në vijim. Guvernatori i BQK-së ka takuar edhe drejtorin e Departamentit



për Tregjet Monetare dhe të Kapitalit (MCM) në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), Tobias Adrian, rikonfirmon bashkëpunimin strategjik në forcimin e stabilitetit financiar. Gjatë takimit guvernatori Ismaili dhe Adrian diskutuan mbi zhvillimet aktuale

ekonomike globale dhe patën një dialog konstruktiv mbi bashkëpunimin e shkëlqyeshëm dhe të vazhdueshëm ndërmjet BQK-së dhe Departamentit MCM të FMN-së. Takimi rikonfirmoi angazhimin e përbashkët për ta vazhduar bashkëpunimin e ngushtë në fusha si mbikëqyrja e bazuar në rrezik për sektorin financiar, parapërgatitja për rastet e krizave, siguria kibernetike dhe zbatimi i standardeve me të mira ndërkombëtare. Në takim u theksua se BQK-ja mbetet e përkushtuar për të punuar ngushtë me partnerët ndërkombëtarë, përfshirë FMN-në, për ndërtimin e një sistemi financiar të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe të gatshëm për të ardhmen.

BANIMI I PËRBALLUESHËM DHE AI SOCIAL PO BËHEN REALITET, GURTHEMELI VIHET NË ISTOG

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

Istog, 30 prill - Kryeministri në detyrë Albin Kurti dhe ministri në detyrë i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, bashkë me kryetarin e komunës së Istogut, Ilir Ferati, vendosën gurthemelin e kompleksit të banimit të përballueshëm dhe social.

Ky kompleks, që do të shtrihet në një sipërfaqe prej 9,120 m², do të ketë gjithsej 65 banesa, prej tyre 52 për banim të përballueshëm dhe 13 për banim social. Kohëzgjatja e punimeve parashihet të jetë tri vjet, kurse vlera e projektit është 4.9 milionë euro. Kompleksi do të ketë katër tipa të banesave: Tipi A me 53 m²; Tipi B me 66 m²; Tipi C me 77 m² dhe Tipi D me 87 m².

Me rastin e vendosjes së gurthemelit, kryeministri tha se qysh në fillim të mandatit të qeverisë patën miratuar agjendën qeveritare për Banim të Përballueshëm dhe Social, që synon qasjen në banim të denjë, të përballueshëm dhe gjithëpërfshirës për të gjithë



qytetarët bazuar në tri parime themelore: gjithëpërfshirje, mossegretim dhe diversitet. “Banimi është e drejtë themelore e njeriut”, tha ai, teksa falënderoi ministrin Aliu, zëvendësm ministrin Jeton Raka, kryetarin Ferati dhe të gjithë ata që kontribuon në këtë projekt dhe uroi punime të mbara e të shpejta. Ministri Aliu theksoi se përpos studimeve të fizibilitetit për banimin social dhe banimin e përballueshëm, është bërë edhe ndryshimi i ligjit, i cili i ka hapur rrugën këtij projekti. Duke dhënë hollësi rreth projektit, ai tha se banimi i përballueshëm do të jetë i kombinuar me banimin social. Banimi social do të jetë në

pronësi dhe menaxhim të komunave, kurse në banimin e përballueshëm, në fund, pronarë do të jenë ata që kanë aplikuar dhe përfituar nga ky program. “Kombinimi i banimit social me atë të përballueshëm bën që të kemi diversitet brenda komplekseve të banimit. Në synojmë politika, ku banesat sociale të jenë të përfshira edhe në zonat e reja zhvillimore, në mënyrë që mos të kemi getoizim të rasteve sociale, siç kemi pasur në të kaluarën”, u shpreh ministri Aliu. Ai uroi që ky projekt të përfundojë sa më shpejt ashtu që çiftet e reja, punëtorët e administratës të mund të përfitojnë nga programi ynë për

banim të përballueshëm. Ndërkaq kryetari Ferati u shpreh se është shumë i gëzuar që komuna e Istogut është e para që po fillon me këtë projekt që, përpos se për qeverinë, sigurisht që edhe për komunën që drejton ai ka qenë me interes jetik, marrë parasysh që ka numër të konsiderueshëm të rasteve që kërkojnë nga komuna që të ofrojnë zgjidhje sa i përket banimit.

Ky projekt është një bashkinvestim i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunave përfituese, ku komunat kontribuojnë me lokacionin dhe infrastrukturën e nevojshme përcjellëse, ndërsa ministria realizon investimet kapitale, përkatësisht projektimin, mbikëqyrjen dhe ndërtimin. Përfitues nga ky program janë çiftet e reja dhe familjet që përbëhen nga prindi vetushqyes, bazuar në kriteret në vijim: nuk e kanë ta zgjidhur çështjen e banimit dhe moshë e njërit nga çiftet të jetë nën moshën tridhjeteshtatëvjeçare. Në janar të vitit 2024, ministria shpalli Thirrjen e Parë Publike për

Komunat, duke ftuar bashkëpunimin institucional në kuadër të programit. Si rezultat, 13 komuna, përkatësisht Peja, Podujeva, Gjilani, Istogu, Kamenica, Rahoveci, Glogoci, Lipjani, Malisheva, Obiliqi, Vushtrria, Shtëmja dhe Ferizaj, dorëzuan aplikime, të cilat u shqyrtuan përmes vlerësimeve analitike dhe vizitave në terren. Në mars 2024 gjithashtu u themelua ekipi i profesionistëve pranë ministrisë për ta mbështetur procesin e zbatimit të projektit në nivel lokal. Ndër komunat që përmbushën kriteret për zhvillimin e projekteve, komuna e Istogut është një nga pesë komunat, së bashku me Pejën, Podujevën, Gjilanin dhe Kamenicën, për të cilat janë hartuar projektet ideore dhe kryesore. Projektet në këto komuna janë pajisur me kushte ndërtimore, ndërsa për tri prej tyre, përfshirë Istogun, janë lëshuar edhe lejet ndërtimore. Deri tani janë nënshkruar katër kontrata me operatorët ekonomikë në shtatë lloje në komunat e Istogut, Gjilanit, Pejës dhe Podujevës, me vlerë totale prej 32 257 752.81 eurosh.

KEDS-i ndërron 100 mijë njehsorë mekanikë e digjitalë përgjatë këtij viti

PRISHTINË, 30 PRILL - KEDS-i ka filluar implementimin e projektit më të ri për ndërrimin e njehsorëve elektrikë, atyre mekanikë dhe digjitalë te konsumatorët shtëpiakë. Arsyeja e ndërrimit të këtyre njehsorëve është se ende disa konsumatorë kanë njehsorë mekanikë nëpër shtëpitë e tyre, ndërkaq një numër tjetër i konsumatorëve kanë

njehsorë digjitalë, të cilët kanë një afat të caktuar përdorimi. Për realizimin e këtij projekti KEDS-i ka arritur marrëveshje me një nënkontraktor, i cili numëron mbi tridhjetë ekipe që po operojnë gjithandej nëpër Kosovë në ndërrimin e këtyre njehsorëve. Këto ekipe, të cilat po ndërrojnë mesatarisht 600 njehsorë në ditë, janë të

pajisura me uniforma të KEDS-it, porse janë të identifikuara si kontraktorë. KEDS-i kërkon mirëkuptim nga konsumatorët që të mos i pengojnë këto ekipe të autorizuar në ndërrimin e njehsorëve. Në të kundërtën, në rast të kundërshtimit të ndërrimit të njehsorëve, KEDS-i ka arritur një marrëveshje edhe me Policinë e Kosovës për

intervenim në raste të tilla. Pas ndërrimit të secilit njehsor elektrik, konsumatorit i lëshohet në vend një procesverbal si dëshmi e ndërrimit të tij, i cili përmban të gjitha hollësitë mbi njehsorin e ri. Ndërrimi i këtyre njehsorëve elektrikë po zbatohet sipas planit, përmes të cilit parashihet të ndërrohen 100 000 sosh përgjatë këtij viti, duke u



bazuar në listën që KEDS-i i ka ofruar kompanisë së kontraktuar, gjithnjë duke qenë nën monitorim të ekipeve përkatëse të KEDS-it.

ALDRICH AMES, AGJENTI I DYFISHTË MË I DËMSHËM NË HISTORINË E SHBA-së

Nga: Myles BURKE / BBC

Në vitin 1985, agjentët sovjetikë që punonin për CIA-n, papritmas zhdukeshin. Një nga një, këto burime të inteligjencës perëndimore u kapën nga shërbimi sovjetik i sigurisë, KGB-ja, u morën në pyetje dhe shumë shpesh u ekzekutuan.

Oleg Gordievsky ishte një nga këta agjentë të dyfishtë. Si shef i stacionit të KGB-së në Londër, ai kishte punuar për vite me radhë fshehurazi për shërbimin britanik të inteligjencës së jashtme, MI6. Por, një ditë e gjeti veten në Moskë, i droguar, i rraskapitur pas pesë orësh marrje në pyetje, dhe përballë mundësisë reale të vdekjes nga skuadra e pushkatimit. Gordievsky shpëtoi pasi MI6 arriti ta nxirrte fshehurazi nga Bashkimi Sovjetik, në bagazhin e një makine.

Më pas, Gordievsky përpigjej të kuptonte se kush e kishte tradhtuar. “Pothuajse për nëntë vjet kam menduar kush ishte ai njeri, kush ishte burimi që më tradhtoi, dhe nuk kisha asnjë përgjigje”, i tha ai gazetarit të BBC-së, Tom Mangold, në një intervistë për Newsnight më 28 shkurt 1994. Dy muaj më vonë, Gordievsky do ta merrte përgjigjen kur veterani i CIA-s, Aldrich Ames, u shfaq në një sallë gjyqi në ShBA dhe pranoi se kishte kompromentuar “pothuajse të gjithë agjentët sovjetikë të CIA-s dhe të shërbimeve të tjera amerikane e të huaja që njihja”.

Më 28 prill 1994, Ames pranoi se kishte zbuluar identitetin e më shumë se 30 agjentëve që spiunonin për Perëndimin, dhe kishte kompromentuar mbi 100 operacione të fshehta. I njohur për KGB-në me emrin e koduar Kolokol (“Zilja”), tradhtia e Amesit kishte çuar në ekzekutimin e të paktën 10 bashkëpunëtorëve të CIA-s, përfshirë gjeneralin Dmitri Polyakov, një zyrtar i lartë i inteligjencës ushtarake sovjetike i cili kishte dhënë informacion për Perëndimin për më shumë se 20 vjet. Ames, spiuni i KGB-së, më shkatërrimtari në historinë e SHBA-së, u dënua me burgim të përjetshëm, pa mundësi lirimi me kusht.

Ashtu si zbulimi i viteve '60 të shekullit XX që tronditi sistemin britanik, se Kim Philby ishte spiun sovjetik, “tani ishte radha e Uashingtonit të përballej me përmasat e dëmit të shkaktuar nga Ames”, ka thënë Mangold në vitin 1994.

Ishte pikërisht roli i Amesit si drejtues i departamentit të kundërzbulimit sovjetik në CIA, ajo që i mundësoi të shkaktonte dëme kaq të mëdha. Ai kishte qasje pothuajse të pakufizuar në informacion të klasifikuar mbi operacionet e fshehta të ShBA-së kundër Bashkimit Sovjetik dhe, ç'është më e rëndësishmja, në

identitetet e agjentëve në terren. Pozicioni i tij nënkuptonte gjithashtu se ai mund të ishte i pranishëm në marrjet në pyetje që kryheshin nga shërbimet e tjera perëndimore të inteligjencës. Kështu ndodhi që spiuni më i vlefshëm i Britanisë, Gordievsky – një kolonel i KGB-së që u jepte informacione jetike dy shërbimeve britanike, MI6 dhe MI5 – të vinte në kontakt me të. Këto takime krijuan një situatë të jashtëzakonshme, ku, siç u shpreh Mangold, “dëmtuesi më i madh i KGB-së po merrej në pyetje nga spiuni më i lartë i KGB-së në CIA”.

“Amerikanët ishin shumë të saktë dhe me të vërtetë shumë të mirë në marrjet në pyetje”, tha Gordievsky. “Unë isha entuziast. Më pëlqenin amerikanët. Doja të ndaja dijet e mia me ta, dhe tani kuptoj se [Ames] ndodhej aty. Që do të thotë se gjithçka, të gjitha përgjigjet e reja të informacionit tim, ai me siguri ia kaloi KGB-së”.

Ames u ekspozua ndaj botës së spiunazhit që në moshë të re. I ati ishte analist i CIA-s dhe e ndihmoi të birin të siguronte një vend pune në Agjenci pasi kishte braktisur kolegjin. Por, vendimi i mëvonshëm i Amesit për të tradhtuar shërbimin e inteligjencës u motivua më pak nga bindjet ideologjike dhe më shumë nga nevoja për para.

Fillimisht, Amesit tregoi potencial si oficer kundërzbulimi. Ai u emërua për herë të parë me bashkëshorten e tij, Nancy Segebarth – gjithashtu agjente e CIA-s – në Turqi në fund të viteve '60 të shekullit XX, ku iu caktua detyra për të rekrutuar agjentë të huaj. Por, deri në vitin 1972, eprorët e tij e rikthyen në selinë qendrore të CIA-s, duke ndier se ai nuk ishte i përshtatshëm për punë në terren. Pasi u kthye në ShBA, studioi gjuhën ruse dhe iu ngarkua planifikimi i operacioneve kundër zyrtarëve sovjetikë.

Karriera e të atit në CIA ishte penguar nga problemet me alkoolin dhe, në mënyrë të ngjashme, edhe vetë Amesit filloi të kishte pengesa për shkak të konsumit të tepruar të alkoolit. Në vitin 1972, ai u kap nga një agjent tjetër, në gjendje të dehur dhe në një situatë kompromentuese me një punonjëse tjetër të CIA-s. Situata u përkeqësua më tej nga qëndrimi i tij shpërfillës ndaj punës – në vitin 1976 ai la një çantë plot me dokumente të klasifikuara në një metro.

Në përpjekje për të rikthyer karrierën në rrugë të mbarë, Ames pranoi një emërim të dytë jashtë vendit, në Meksiko-Siti në vitin 1981, ndërsa gruaja e tij qëndroi në Nju-Jork. Por, sjellja e tij dhe vazhdimi i konsumit të tepërt të alkoolit bënë që të mos spikatej as atje si oficer i CIA-s. Në vitin 1981, ai u përfshi në një aksident trafiku në Meksiko-Siti dhe ishte aq i dehur saqë nuk ishte në gjendje t'u përgjigjej



pyetjeve të policisë apo të njëjtte një zyrtar të Ambasadës amerikane që kishte shkruar për ta ndihmuar. Pas një debati të rëndë, me sharje dhe në gjendje të dehur – me një zyrtar kuban gjatë një pritjeje diplomatike në Ambasadë – eprori i tij rekomandoi që, pas kthimit në ShBA, CIA ta vlerësonte për varësi ndaj alkoolit.

Ames gjithashtu vazhdoi të kishte lidhje jashtëmartesore, njëra prej të cilave do të rezultonte si pikë kthese në jetën e tij. Nga fundi i vitit 1982, ai nisi një marrëdhënie me një atashë kulturore kolumbiane, të rekrutuar për të punuar për CIA-n, Maria del Rosario Casas Dupuy. Marrëdhënia e tyre u bë gjithnjë e më serioze, derisa Ames i vendosi të shkurorëzohej nga gruaja e parë, të martohej me Rosarion dhe ta sillte me vete në ShBA.

Përkundër performancës së tij jo të lavdërueshme në CIA, Ames vazhdoi të ngjitej në karrierë. Pas kthimit në selinë qendrore të Agjencisë në vitin 1983, ai u emërua shef i degës së kundërzbulimit për operacionet sovjetike, duke pasur qasje të gjerë në informacion të ndjeshëm mbi aktivitetet e fshehta të CIA-s.

Ames kishte rënë dakord, si pjesë e marrëveshjes së divorcit me Nancyn, të paguante borxhet që kishin krijuar si çift, si dhe një pagesë mujore për të. Këtyre u shtuan edhe shijet e shtrenjta të gruas së tij të re, Rosario – pasioni i saj për blerje dhe telefonatat e shpeshta me familjen në Kolumbi. Problemet financiare të Amesit dolën jashtë kontrollit. Më vonë, ai do t'i thoshte senatorit të Arizonës, Dennis DeConcini, se ishin borxhet në rritje ato që e shtynë të mendonte për shitjen e sekreteve që kishte në dorë. “Ndjeja një presion të madh financiar, i cili, në retrospektivë, ishte diçka ndaj së cilës reagova në mënyrë të pamatur”, ka thënë Ames.

“Ishte për para dhe nuk besoj se ndonjëherë u përpoq seriozisht t'i bënte njerëzit të besonin se ishte për ndonjë arsye tjetër”, tha

BBC Witness History në vitin 2015, agjenti i FBI-së, Leslie G. Wiser, i përfshirë në hetimin që çoi në arrestimin e Amesit. Më 16 prill 1985, pasi kishte pirë disa gota për të mbledhur guximin, Aldrich Ames hyri drejt e në Ambasadën ruse në Uashington. Sapo hyri, i dorëzoi receptionistes një zarf që përmbante emrat e disa agjentëve të dyfishtë, dokumentet që tregonin kredencialet e tij si pjesëtar i brendshëm i CIA-s, dhe një shënim ku kërkonte 50 mijë dollarë. Ai pohoi më vonë, në një raport të Senatit, se fillimisht kishte besuar se kjo do të ishte marrëveshje e vetme sa për ta nxjerrë atë nga gropa financiare, por shumë shpejt e kuptoi se kishte “kaluar një vijë dhe nuk mund të kthehesha më pas”.

Për nëntë vjetët që pasuan, Ames u pagua për t'i dhënë KGB-së një sasi të madhe informacioni tepër sekret. Ai merrte dokumente të klasifikuara – që përshkruanin gjithçka, nga pajisjet e përgjimit të lidhura me qendrën hapësinore të Moskës deri te teknologjitë e sofistikuara që numëronin mbushjet bërthamore të raketave sovjetike – i mbështillte në qese plastike dhe thjesht i nxirrte jashtë godinës së CIA-s. Pasi roli i tij përfshinte takime zyrtare me diplomatë rusë, ai mund të takonte shpesh agjentët e tij ndërlihdhës, pa ngjallur dyshime. Po ashtu, ai linte paketa me dokumente të klasifikuara, në vende të fshehta të paracaktuara të quajtura dead drops.

“Nëse do të realizonte një takim [dead drop], më herët vendoste, për shembull një shenjë me shkumës në një kuti postare, dhe rusët e shihnin atë shenjë, duke kuptuar se dokumentet ishin dorëzuar”, ka thënë Wiser. “Më vonë, kur i merrnin dokumentet, shkonin dhe fshinin shenjën me shkumës. Kështu, ai e kuptonte se dorëzimi ishte bërë në mënyrë të sigurt dhe të suksesshme”.


Ndodhi që përmes rrjedhjeve të informacionit sekret nga Ames, KGB-ja identifikoi pothuajse të gjithë spiunët e CIA-s në

Bashkimin Sovjetik, duke shkatërruar efektivisht operacionet e fshehta amerikane atje. “Nuk jam në dijeni për ndonjë spiun apo ‘gjurmues’ [mole] tjetër në ShBA, që ka shkaktuar humbje kaq të madhe njerëzore në aspektin e burimeve të inteligjencës”, tha Wiser. Zhdukja e papritur e kaq shumë burimeve të CIA-s ngriti alarmin dhe nisi kërkimin për spiunin brenda Agjencisë në vitin 1986, por Ames arriti të qëndronte i padukshëm për pjesën më të madhe të dekadës. Dhe, ai u shpërblye bujarisht për tradhtinë e tij – duke marrë rreth 2.5 milionë dollarë nga Bashkimi Sovjetik. Ames bëri pak përpjekje për të fshehur pasurinë e re. Megjithëse nuk kishte pasur kurrë një pagë më të lartë se 70 mijë dollarë në vit, ai bleu një shtëpi të re me vlerë 540 mijë dollarë, në para të gatshme, shpenzoi dhjetëra mijëra të tjera për riparime në shtëpi dhe bleu një makinë Jaguar. Ishte pikërisht stili i jetesës dhe shpenzimet e tij ekstravagante që e vunë në shënjestër dhe çuan në arrestimin e tij më 1994 nga ekipi i FBI-së i drejtuar nga Leslie G. Wiser.

Pasi u arrestua nga FBI-ja, Ames bashkëpunoi me autoritetet. Ai rrëfeu shtrirjen e veprimtarisë së tij të spiunazhit, në këmbim të një marrëveshjeje që i siguronte një dënim më të lehtë për Rosarion e cila pranoi se kishte ditur për paratë dhe takimet e tij me sovjetikët. Ajo u lirua pas pesë vjetëve. Ames, oficeri më i lartë i CIA-s i zbuluar ndonjëherë si agjent i dyfishtë, vazhdon të vuajë dënimin e përjetshëm në një burg federal amerikan në Tera Hot të Indianës.

Deri më sot, Ames ka shfaqur shumë pak pendesë për veprimet e tij apo për vdekjet që ato shkaktuan. “Ai kishte një mendim shumë të lartë për veten”, tha Wiser për Amesin. “Pendohet që u kap. Nuk pendohet që ishte spiun”.

/Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Më 10 maj turniri tradicional ‘Demush Mavraj’

ISTOG, 30 PRILL - Më 10 maj do të organizohet turniri tradicional për ish-arsimtarin e Edukatës Fizike dhe dëshmorin e kombit, Demush Mavraj. Stafi organizativ ka filluar përgatitjet për turnirin

që organizohet për nder të 26-vjetorit të rënies heroike të luftëtarit të UÇK-së. Turniri në futboll të vogël do të organizohet në qendrën sportive “IBOS” në Istog, kurse pritet të jetë madhështor

sikurse në vitin e kaluar. “Paraqitja e ekipit do të jetë 40 euro. Vendi i parë do të shpërblehet me 1 500 euro si dhe me Kupë dhe medalje, për vendin e detyrë do të ndahen 50 euro dhe Kupë e medalje.

Çmime do të ketë edhe për lojtarin më të mirë dhe portierin më të mirë. Pjesëmarrja juaj e nderon dëshmorin”, thuhet në njoftim. Hedhja e shortit do të bëhet më 9 maj në orën 21:00.



Qerimi shpall listën për ndeshjet me Ishujt Faroe dhe Holandën

PRISHTINË, 30 PRILL - Selektori i Kosovës në hendboll, Bujar Qerimi, ka shpallur të mërkurën listën e hendbollistëve të ftuar për ndeshjet me Ishujt Faroe dhe Holandën. Për herë të parë në ekipin e zgjeruar është ftuar Amar Muqolli, ndërsa kthehet Olsi Mulaj. Bëhet fjalë për dy hendbollistët e talentuar të Besa Famgas që shkëlqyen me Kosovën U18. Kthehet edhe Arbios Mushkolaj që mungoi në ndeshjet e kaluara për shkak të një lëndimi. Kosova grumbullohet të dielën mbrëma, më 4 maj, kurse stërvitet fillojnë të hënën. Ndeshja Kosovë - Ishujt Faroe është më 8 maj nga ora 20:15 në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Ndeshja me Holandën është më 11 maj



në 's-Hertogenbosch. Janë këto dy ndeshjet e fundit kualifikuese për “Euro 2026”. Kosova kërkon suksesin për kualifikim historik. Në Grupin 6, Ishujt Faroe janë

në vendin e parë me 5 pikë. Nga katër i kanë Ukraina e Holanda, ndërsa Përfaqësuesja e Kosovës i ka tri pikë. Gara në grup është plotësisht e hapur.

LISTA E HENDBOLLISTËVE

Valon Dedaj, Arti Luzha, Kushtrim Ninaj, Arbios Mushkolaj, Mali Luzha, Luigi Quni, Drilon Tahirukaj,

Lulzim Shabani, Haris Berisha, Buja Ramosaj, Jon Muqolli, Lonard Gegaj, Rron Ramadani, Olsi Mulaj, Egzon Gjuka, Matej Thaqi, Amar Muqolli, Liridon Zena, Drenit Tahirukaj.

Rahoveci synon hapin e parë drejt finales



Rahovec, 30 prill - Pas një turneu shumë të mirë të Kupës së Kosovës në Hendboll, gara vazhdon në kampionatin e Kosovës. Në mesjavë janë ndeshjet e para të gjysmëfinales së plejofit. Të mërkurën prej orës 20:00 është takimi Rahoveci - Prishtina që zhvillohet në palestrën “Mizahir Isma”. Rahoveci e ka

përfunduar stinorin e rregullt në pozitën e parë. I fitoi të gjitha ndeshjet, pos njëres në të cilën barazoi me Kastriotin. “Vreshtarët” u ndalën në gjysmëfinale të Kupës së Kosovës, por janë të përkushtuar ta mbrojnë titullin e kampionit. Prishtina stinorin e rregullt e përfundoi në pozitën e katërt. Në finale kalon

skuadra që i shënon dy fitore. Pas ndeshjes së dytë në Prishtinë, ndeshja e tretë eventuale do të jetë në Rahovec. Në gjysmëfinalen tjetër takohen Kastrioti e Besa Famgas. Te hendbollistet, gjysmëfinalet e plejofit janë Istogu - Shqiponja dhe Ferizaj - Samadrexha. Këto ndeshje janë të enjten.

Hapet Liga e Shkollave, synohet zbulimi i talentëve të futbollit

Prishtinë, 30 prill - Liga e Shkollave të Prishtinës është projekti i ri sportiv dhe edukativ që synon t'i kultivojë talentet e reja dhe ta forcojë frymën e garës së ndershme mes nxënësve. Kjo ligë, e cila krijohet nga bashkëpunimi ndërmjet komunës së Prishtinës dhe Federatës së Futbollit të

Kosovës, synon të jetë një platformë për zbulimin e yjeve të ardhshëm të futbollit dhe ta promovojë sportin si vlerë edukative e shoqërore. Kryetari i FFK së, Agim Ademi, në hapjen zyrtare theksoi se ky program që po nis në kryeqytet do të shtrihet në të gjithë

Kosovën. Ai shtoi se qëllimi kryesor i këtij aktiviteti është që nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme ta kenë sportin si aktivitetin e tyre kryesor dhe të qëndrojnë sa më larg përdorimit të tepruar të pajisjeve teknologjike. Ndërsa kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se

kjo ligë është një nismë e mrekullueshme pasi që ajo i kontribuon mirëqenies së shëndetit fizik dhe mendor, si dhe ofron mundësi që të hulumtohen dhe identifikohen talentet e rinj të futbollit. Ndeshja e parë e kësaj lige u zhvillua ndërmjet ShFMU “Dardania” - ShFMU “Faik



Konica”, derisa në vazhdim pjesë e kësaj lige do të jenë gjithsejtë 44 shkolla fillore dhe 13 të mesme me mbi 500 nxënës të përfshirë.

Shefi i McLarenit: E dimë se Piastri dhe Norrisi do të përballen fort në pistë

SURREY, 30 PRILL - Me fitoren e arritur në garën e fundit në Jedah, piloti Oscar Piastri ka marrë frenat e renditjes dhe, ndoshta, ka marrë edhe kreun e hierarkisë të McLarenit, duke lënë pas Lando Norris. Ai bëhet

australiani i parë që kryesoi Botërorin e Formulës 1 dhe synon ta mbajë kreun edhe pas garës së kësaj fundjave në Majemi. Në Florida, Piastri mbërrin si favorit dhe mbetet për t'u parë nëse mund ta përballojë presionin

që Norrisi do të ushtrojë. Kjo do të thotë se dy pilotët e McLarenit do të përballen fort në pistë për fitoren, çka pritet të jetë një duel që do të përsëritet disa herë përgjatë këtij sezoni. CEO i McLaren, Zak Brown,

është i bindur për këtë përballje dhe pranon se për të është thjesht çështje kohe që gjërat të ndërlikohen. "E dimë se është më shumë një 'KUR' sesa një 'NËSE'. Kemi dy pilotët të shkëlqyer që garojnë fort dhe diçka do të ndodhë.



Kjo është bota e garave, kështu që jam i emocionuar", ka thënë Browni.

Arrihet marrëveshja, Lara Colturi do të vazhdojë të garojë për Shqipërinë

TIRANË, 30 PRILL - Federata Shqiptare e Skive, përmes një postimi në faqen e saj zyrtare në "Instagram", ka njoftuar se skiatorja Lara Colturi do të vazhdojë të jetë pjesë e Shqipërisë edhe në të ardhmen. Prej ditësh ishte përfolur një largim i saj drejt Italisë, vendit të saj të lindjes. "Një lajm i mirë për Shqipërinë dhe sportin e skive. Është arritur marrëveshja që sportistja Lara Colturi të vazhdojë të garojë për Shqipërinë edhe për sezonin sportiv 2025-2026. Po punohet intensivisht për detajet e kontratës", thuhet në deklaratën e Federatës Shqiptare të Skive. "I urojmë Larës suksese në shkollë këto ditë. Përveç sportit dhe karrierës në sport, Lara mbyll këtë vit edhe studimet e shkollës së mesme. Suksese Larës dhe Shqipërisë në Lojërat



Olimpike", thuhet më tej në deklaratën e publikuar. Siç dihet, vitin tjetër do të zhvillohen në Milano-Cortina (Itali) Lojërat Olimpike Dimërore dhe Lara Colturi ka shanse të sigurojë medalje. Këtë sezon, ajo u ngjiti tri herë në podium në garat e Kupës së Botës për femra në ski (dy vende

të dyta dhe një të tretë). Pak javë më parë u përfol se Colturi, 18 vjeçe, mund të rikthehej të garonte për vendin e saj, pasi kishte bërë kërkesë në KOKSh për ndryshimin e kombësisë (ajo ka pasaportë shqiptare prej disa vitesh). Ajo ka nderuar flamurin kuqezi në garat e Kupës së Botës sezonin e fundit.

Bostoni dhe Indiana kualifikohen në gjysmëfinalet e 'play-off'-it

BOSTON, 30 PRILL - Ndeshjet e sotme në NBA kanë përcaktuar edhe dy skuadra të tjera gjysmëfinaliste, të dyja në Konferencën e Lindjes. Njëri prej tyre është Boston Celtics, që mundi me rezultat 120-89 Orlandon dhe fitoi 4-1 serinë e çerekfinaleve. Kampionët në fuqi patën epërsi gjatë gjithë kohës, ku u dallua Jayson Tatum me 354 pikë e 10 asistime. Në gjysmëfinale shkon edhe Indiana, që mundi me rezultat 119-118 Milwaukee, duke fituar 4-1 serinë e takimeve. Fitore në sekondën e fundit për Indiana, ndërkohë që titullarët e të dyja skuadrave realizuan mbi 10 pikë çka tregon për rivalitetin e madh në fushë. Kështu, Antetokounmpo largohet nga gara për titull. Po në Lindje, Detroiti fitoi me rezultat 106-103 ndaj New York dhe mban ende



hapur shpresat për kualifikim, pasi tani nju-jorkezët udhëheqin 3-2 serinë. Cunningham me 24 pikë dhe Thompson me 22 pikë u dalluan për Pistons në këtë ndeshje. Në Perëndim u luajt vetëm një ndeshje, ku Denveri

mposhti pa problem me rezultat 131-115 Clippers, duke udhëhequr 3-2 serinë e çerekfinaleve. Jamal Murray me 43 pikë ishte lider në fushë për Denverin, mbështetur nga Jokiq me një "triple double".

SHKURT

Kumbulla përfshihet në formacionin e muajit për La Ligën

Mbrojtësi Marash Kumbulla është "ringjallur" te Espanyoli. 25-vjeçari, i huazuar nga Roma, ka bërë mirë gjatë gjithë sezonit dhe sidomos këtë muaj. "WhoScored" e ka përzgjedhur në formacionin e muajit prill për La Ligën. Bashkë me disa lojtarë të Espanyolit në mbrojtje janë treguar spektakolarë, teksa klubi ka fituar pikë të rëndësishme për mbijetesën. Pjesë e formacionit janë edhe lojtarë si Yamal dhe Rafinha. Të dy pjesë e Barcelonës që po marshon drejt titullit kampion. Kumbulla shënoi edhe një gol fitoreje gjatë këtij muaji. Forma e mirë pas disa dëmtimeve ka bërë që Kumbulla të marrë më shumë minuta te Kombëtarja. Formacioni: Garcia, El Hilali, Cabrera, Kumbulla, Gaya, Exposito, Isco, Darder, Yamal, Iglesias, Raphinha.

Moenchengladbachu interesohet për Manajn

Borussia Moenchengladbachu po sfidon Fenerbahçen, Beshiktashin e Tranbzonsporin për shërbimet e sulmuesit të Shqipërisë, Rey Manaj. Mediet turke kanë raportuar se Manaj pritet që këtë verë të transferohet në Gjermani, pasi skuadra e Gladbachut është gati të paguajë 4 milionë euro për kartonin e tij. Manaj është pjesë e Sivassporit, ekip me të cilin ka kontratë deri në verën e vitit 2026, kurse këtë sezon ka treguar formë të mirë. Në 25 ndeshje të luajtura me fanellën e Sivassporit, sulmuesi 28-vjeçar ka shënuar 11 gola dhe ka bërë 5 asistime.

Arteta: Meritonim një barazim, shkojmë në Paris për fitore

Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, ka thënë e kanë merituar të paktën një barazim në ndeshjen ndaj PSF-së (0-1). Ai ka thënë se në ndeshjen kthyesë në Paris shkojnë për fitore. "Jam i zhgënjyer nga rezultati. Dhamë shumë në këtë ndeshje. Në 10-15 minutat e para e kishim të vështirë të gjenim ritmin. Është zhgënjyes fakti që nuk morëm të paktën një barazim. Goli i pësuar? Ky është rreziku, por në këtë rast është edhe për meritë të tyre, gjithsesi, kjo ishte vetëm pjesa e parë. Të njëjtën gjë kam thënë edhe pas sfidës së parë kundër Real Madridit. Nuk na mbetet gjë tjetër vetëm të shkojmë në Paris dhe të fitojmë. Mendoj se shanset për kualifikim janë ende 50/50", u shpreh Arteta.

Enrique: Gjithçka e hapur për kualifikim

Pavarësisht se ekipi PSG-ja mori fitore në sfidën e parë kundër Arsenalit, trajneri Luis Enrique beson se gjithçka është ende e hapur. "Është një rezultat i mirë, por mund të shkonte më mirë, por edhe më keq. Objektivi i parë u arrit, është i qartë objektivi edhe në ndeshjen e kthimit, duhet të fitojmë. Nuk duhet të bëjmë llogari kundër një rivali që mund të shënojë në çdo formë. Ndeshja e kthimit do të jetë shumë emocionuese për tifozë, por shumë stresuese për ne trajnerët, por ne jemi gati", ka thënë Enrique.

Gjashtë javë pezullim për Rudigerin, dy javë për Vazquezin

Mbrojtësi gjerman i Real Madridit, Antonio Rudiger, është dënuar me gjashtë ndeshje pezullim nga komisioni disiplinor në Spanjë, pas një proteste të ashpër në fund të finales së Kupës së Mbretit ndaj Barcelonës. Nga bankina,

Rudigeri hodhi akull në drejtim të gjyqtarit dhe u ndëshkua menjëherë me karton të kuq. Megjithatë, pezullimi nuk do të ketë shumë ndikim për lojtarin, pasi ai ka vendosur të bëjë ndërhyrje kirurgjikale në gju, katër javë para përfundimit të

La Ligës, duke mbyllur kështu sezonin përpara kohe. Përveç mungesës në fundin e kampionatit, Rudigeri nuk do të jetë në dispozicion as për kombëtaren gjermane në finalët e Ligës së Kombeve. Ky incident ka shkaktuar polemika

edhe në Gjermani, ku drejtori sportiv i kombëtares, Rudi Voller, ka lënë të kuptohet se do të ketë masa disiplinore ndaj lojtarit. Ndërkohë, dy ndeshje pezullim janë dhënë edhe për Lucas Vazquezin, i cili u përfshi në tensionet në fund të

ndeshjes. Në anën tjetër, Jude Bellinghami është shpallur i pafajshëm pas prezantimit të një video nga ana e Real Madridit, ku vërtetohej se anglezi nuk kishte bërë asgjë që justifikonte kartonin e kuq të dhënë nga gjyqtari.

Thirrje për aplikim

Kushtrim E. Kabashi B.I., NUI 812273762, po kërkon ofertues / kontraktor / kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë ofertë / propozim për:

Sistem antibreshër për sipërfaqen ekzistuese të pemishtes së boronicës 3 ha

Nr. Prokurimit 01/25 - Kushtrim E. Kabashi B.I

Emri: Kushtrim E. Kabashi B.I

Të interesuarit për aplikim dosjen me specifika mund ta kërkojnë përmes e-mailit: ducikastrati@gmail.com, Adresa: Fshati Gjurakoc, Komuna Istog, Republika e Kosovës, Tel: +383 45 291 900

Ofertat duhen dorëzuar më së largu 15 ditë nga publikimi i shpalljes, ora 15:00, në Adresë: Kushtrim E. Kabashi B.I., Fshati Gjurakoc, Komuna Istog, Republika e Kosovës.

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Autoshkolla ARGJ ABC” SH.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811998337 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Autoshkolla ARGJ ABC” D.O.O. Mitrovicë, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811998337 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Autoshkolla ARGJ ABC” L.L.C. with headquarters Mitrovicë, has come to the decision to quit its business: 811998337 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fatbardh Kabashi shpall të pavlefshme certifikatën QK “11 Marsi” Prizren.

- Arber Kryezi shpall të pavlefshme diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.

- Mustaf Mustafa shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Motrat Qiriaz” Prizren.

- Betim Katana shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Fitnete Neziri shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Ekrem Rexha” Prizren.

- Gezim Kosova shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Motrat Qiriaz” Prizren.

- Ensar Butuc shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “Motrat Qiriaz” Prizren.

- Laokont Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Syla Hodaj B.I. shpall të pavlefshme numrin e biznesit me nr.811142562 të lëshuar nga ATK.

- Leotrim Qevani shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu “Hamëz Cena” Damjan Gjakovë.

- Ari Mamusha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 10,11,12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

- Lirigzon Morina nga Senoci i Rahovecit shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10,11,12 dhe diplomën e shkollës së mesme profesionale “Selajdin Mullaabaz-Mici”, Rahovec.

- Fadil Dujaka nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Sh.M.Teknike “Nexhmedin Nixha”, Gjakovë.

- Besart Bardhi nga Tropoja e Shqipërisë shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 12 dhe diplomën e lëshuar nga Sh.M.Teknike “Nexhmedin Nixha”, Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1909

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

